**Libani – mbretëria e ëndrrave arabe dhe gjaku që s'e lanë të thahet**

**"Hotel Bejruti"**

**Nt: "Hotel Ruanda" dhe "Hotel Bejruti", dallojnë vetëm në kohë, - Si u shndërrua një shtet luksi në gërmadha biblike,- Pashko Vasa aty dashuroi, udhëhoqi dhe përgatiti projekte madhore për pavarësinë e Shqipërisë, - Si armatoseshin palët për një luftë që i gëlltiti të gjithë, - Ëndrra e korrespondentëve të luftës për një linjë teleksi, - Si e përjetova masakrën në Sabra e Shatila, - Mbi 200 miliardë dollarë, të cilët i hëngrën baruti dhe botëkuptimet feudale, e që ende po gjallojnë në Liban**

**Nehat Islami**

Filmi i njohur i Teri Gjorgjit "Hotel Ruanda" ka lindur tridhjetë vjet pas metaforës "Hotel Bejruti", e cila dëgjohej në kafenetë e kryeqytetit libanez nga pranvera e vitit 1975, kur nisi lufta, të cilën disa e quanin "civile", kurse të tjerët "gjakderdhje fisesh". Ajo filloi të rrokullisej si një ortek nga malet e larta plot borë të Antilibanit gjer në brigjet e ngrohta të Mesdheut Lindor Libanez. Kjo "Zvicër", atëbotë me tre milionë banorë, jetonte "allafrënga". Vetëm në rrugën kryesore të Bejrutit, "Hamra", ku në shekullin e nëntëmbëdhjetë, shqiptarët i kanë pasur me shumicë pronat e tyre, gjendeshin selite e 99 bankave të mëdha botërore. Ishte qendër e 60 redaksive të gazetave të përditshme dhe e revistave që botoheshin me paratë e shteteve arabe, sipas ngjyrimeve politike të mbështetësve të tyre financiarë. Libanezët luanin rolin e zëdhënësve të tyre. Vetëm Bejruti kishte mbi 400 hotele me pesë yje, por edhe bujtina, andaj e quanin për sharm "Hotel Bejruti". Në ato hotele, simbole të qytetit, kanë fjetur njerëzit më të mëdhenj të kësaj bote, duke filluar nga Napoloni, De Goli, aktore botërore, gjeneralë, spiunë e karagjozë të ndryshëm të kalibrit botëror, gjer te nobelistët e shquar. Në Libanin demokratik, siç dëshironin ta emërtonin jo vetëm libanezët, shkruhej ajo që nuk lejohej në pjesën tjetër të botës arabe. Kështu të gjithë ishin të kënaqur, si libanezët, ashtu edhe metropolet arabe, përherë në konflikte ideologjike, sektare dhe gjeostrategjike me njëra-tjetrën.

Porti i Bejrutit, ndër më të mëdhenjtë në regjion, të cilit ia vuri një "vulë" edhe konstruktori shqiptar, poeti ynë i madh, inxh. Filip Shiroka, furnizonte me mallra shumë shtete arabe. Në këtë shtet, në esencë feudal por me shkëlqim të rremë, pakkush ia bartte gajlen parasë. Për krerët e partive dhe rrethin e tyre kishte sa të donin, kurse për të tjerët, sa për të jetuar në nivel të shteteve të pasura me naftë, ndonëse Libani nuk kishte një pikë nafte, por turizëm, tregti dhe njerëz të aftë t'i menaxhonin paratë e arabëve të tjerë.

**Siria e njohu Libanin pas një shekulli**

Ndonëse Siria fqinje dhe tutore e përhershme nuk e kishte njohur formalisht këtë fqinj të vogël gadi nje shekull, ajo megjithatë kishte punësuar në Liban mbi 300 mijë shtetas të saj, kryesisht në ndërtimtari dhe në punë të tjera krahu, duke zgjidhur kështu shumë probleme të saj sociale, kurse libanezët merrnin krahë të lirë dhe të përulur pune, deri pesë herë më të lirë se vendorët.

Libani dhe Siria ishin vetëm territore të Portës, gjer në përfundimin e Perandorisë Osmane (1920), e pastaj, sipas Planit britaniko-francez, Sajks-Piko, të cilin e miratoi Liga e Popujve, u vunë nën mandat të Francës, por si dy vende të veçanta. Këtë verdikt të superfuqive, Siria nuk e njohu , duke e konsideruar Libanin "territor të vetin". Ishte ai njëfarë raporti sui generis, kur shtetet bashkëpunojnë, madje shumë ngushtë, por pa njohje diplomatike. Me ne fund, me 2010, Damasku u detyrua ta njohe Libanin si shtet. Kjo ndodhi pas atentatit sirian kunder kryeministrit shume te popullarizuar libanez, Haririt,kur nga mellefi i brendshem, Siria u detyra ta terheqe armaten e saj nga Libani dhe ta ta njohe edhe formalisht pavaresine e tij.

Moda që si sot hapte syrin në Paris e Londër, të nesërmen arrinte në Bejrut, kurse turizmi i shkallës së lartë ua kalonte edhe vendeve të zhvilluara të Evropës. Plazhet e Bejrutit me asgjë nuk dallonin nga ato të Kanës apo të ndonjë Kapa-Kabane. Sot, "Pranvera arabe" po bën përpjekje t'ua kufizojë femrave lirinë e rrobave të banjës, por pa ndonjë sukses të madh.

Në këtë pikëpamje, Bejruti nuk ka ndonjë ngjashmëri me "Hotel Ruandën". Të tjerat gati janë njësoj. Gjatë luftës 15-vjeçare, Libani në 10.450 kilometra katrorë u shkatërrua edhe nga paaftësia e shteteve arabe dhe e faktorit ndërkombëtar për ta zgjidhur konfliktin e përgjakshëm, kurse në Ruandën e OKB-së, u kryen krime mizore në prezencë të helmetëkaltërve. A po jua kujton kjo një paralajmërim të hershëm të Srebernicës dhe jo vetëm të asaj?

**Bejruti, vend shpëtimi i të përndjekurve**

Libani ka qenë vendstrehim i shumë azilantëve politikë të botës arabe, ku gjenin mbrojtje pas ndonjë grusht shteti në vendin e tyre ose kur i ndiqnin për çështje politike. Ndër ta ka qenë edhe Sadam Huseini, pas një grusht shteti të pasuksesshëm. Sipas dëshmitarëve të kohës, ai i ndërronte kafenetë dhe banesat për çdo ditë, për të fshehur gjurmë. Ai u kthye në Irak pas grusht shtetit të BAAS-istit Hasan el Baker, të citit Sadami, nënkryetar, ia rrëmbeu postin e presidentit më 1979 "me të mirë". Në Liban ka qenë azilant edhe kurdi Xhelal Talabani, kryetar i tanishëm i Irakut. Ai gjeti strehim në Liban në vitin 1975, pas marrëveshjes së lidhur në Algjeri midis Irakut dhe Iranit, kur Irani e "la në akull" Lëvizjen kurde për autonominë e Irakut të Veriut. Pastaj, Talabani kaloi në Damask, ku jam takuar për herë të parë me të. Atë takim e kam përshkruar në një reportazh.

**Pashko Vasa ose guvernatori që ia vuri themelet një shteti të ardhshëm**

Me të arritur në Bejrut, në vjeshtën e hershme të 1974-s në detyrën e korrespodentit të përhershëm të "Rilindjes" për Lindjen e Afërt. Vizitën e parë ia bëra varrit të Pashko Vasës, guvernator i Libanit (1883-1892), këtij kolosi të çështjes sonë kombëtare, shkrimtarit, diplomatit dhe, mbi të gjitha, shtetarit që diti t'i krijonte piketat e Rilindjes sonë kombëtare, duke përfshirë edhe organizimin e Lidhjes së Prizrenit.

Varri i tij i skalitur në mermer të bardhë është mirënjohje e libanezëve për njeriun që e udhëhoqi nëntë vjet Libanin, duke e mundur kolerën me metodat më bashkëkohore të sjella nga mjekët britanikë dhe francezë dhe duke e modernizuar këtë vend. Ai arriti t'i qetësonte gjakrat gufues të fiseve druze, të maronitëve, të sekteve sunite dhe shiite, kurdëve, etj.

Me 1860, Libani u bë një njësi e re autonome, e lidhur drejtperdrejte me Porten. Guvernatori caktohej nga Porta, me pelqimin e fuqive te medha. Pashko Vasa ka qene guvernatori i katert i vendit.

Në pallatin e të parit të vendit, ky njeri qëndroi i vetmi nga të gjithë guvernatorët që nuk e kishte ndryshuar as një germë të emrit dhe mbiemrit të tij të origjinës, ndonëse ishte në shërbim të Portës. Të gjithë "mutasherifët"(guvernatorët) e tjerë e ndërronin emrin. Një guvernator i ardhur nga Polonia, ishte fshehur tërësisht pas gjeneralieve të reja: Jusef Pasha.

Netët e kthjellëta të Bejrutit, Pashko Vasa ia kushtonte çështjes së vet kombëtare, duke këmbyer letra e porosi me krerët më të njohur të Lëvizjes kombëtare që nga Stambolli, Shkodra, Prizreni, Vjena e Bukureshti, për ta bërë Shqipërinë dhe bashkimin kombëtar mbi himnin e tij "…feja jonë është shqiptaria".

Sa herë që na merrte malli t'i gjendesha pranë njeriut tonë, blija lule të freskëta dhe me familjen time ia mësynim kuartit Hazmije ku prehej Pashko Vasa. Nuk ndieja vetmi në atë metropol, sepse me vete e bartja emrin e tij që më bënte nder para çdo libanezi.

Për jetën dhe veprën e Pashko Vasës shkrova ato kohë një fejton në bazë të dokumenteve që i gjeta në dosjen e historianit të njohur libanez, të ndjerit Lahed Hater (1881-1975) dhe nga burimet tjera.

Një detaj nuk e harroj nga qyteti antik i Balbekut, në kufi me Sirinë. Pashko Vasa kishte urdhëruar të skalitej emri i bashkëshortes së tij të parë (të ndjerë) Maria, që e deshi fort, mu në portën hyrëse të qytetit, mbi shtylla graniti.

"Shqiptari kur dashuron, këtë e bën edhe me qytete antike"- bënim batuta me kolegun libanez, Eduard Saab, korrespondent i gazetës "Le Monde", lider i korrespodentëve të huaj në këtë vend. Ky gazetar, sa punëtor e gazmor, aq edhe fatkeq, u godit nga plumbat e luftës, në muajt e parë të luftës së pashpallur libaneze.

**Autobusi që shënoi fillimin e luftës 15-vjeçare**

Në Liban, në dukje të jashtme çdo gjë rridhte relativisht qetë gjer më 13 prill 1975, kur në kuartin "Ein el Ramaneh" të Bejrutit u sulmua në pritë me shumë armë automatike një autobus me gra e fëmijë palestinezë. Aty u vranë 27, ndërsa u plagosën 19 veta që po ktheheshin nga një kremtim. Atë ditë, realisht u hap "Arka e Pandorës" dhe filloi një luftë ndërmjet "progresistëve" (të gjithë ata që mbronin çështjen palestineze) dhe "falangistëve" e të tjerëve, që donin në çdo mënyrë t'i shkatërronin palestinezët. Hakmarrja palestineze ngjau në Damur, ku u vranë rreth 300 kundërshtarë. Së " djathtes" libaneze i printe Pjer Xhemajli, lider i partisë "Kataeb", që ishte një falangë e krijuar sipas mostrës fashiste të para Luftës së Dytë Botërore. Pjer Xhemajli ishte një futbollist dhe hedhës i gjyles, me profesion farmacist, që shkoi për t'i përcjellë lojërat olimpike të vitit 1938 në Berlin, mu atëherë kur Hitleri ishte në zenit. Aq shumë i pëlqeu ajo filozofi këtij djaloshi feudal, sa që, me t'u kthyer në Liban, formoi Partinë falangiste, më e fuqishmja në vend. Gjatë luftës libaneze kishte më se 5.000 njerëz nën armë. Rrugën e babait e vijuan edhe dy djemtë e tij, të cilët bënë shumë krime, por edhe vetë ranë nga duart e atentatorëve. Ishin edhe "murabitunët" e Kamij Shamunit, një feudali dhe tregtari armësh që specialitet e kishte artilerinë e rëndë për të gjitha tregjet arabe dhe më gjerë. Në krahun e " djathte" ishte edhe Sulejman Franzhije, feudal dhe prijës i maleve të Zgortes, pa ndonjë nivel të shkollimit, por shumë i rafinuar për të bërë aleanca sipas interesit, brenda natës vetëm e vetëm për të shkatërruar qenien palestineze. Kjo luftë, ndonëse dukej e ndarë sipas konfesioneve, e të tilla në Liban ishin 18, në esencë ishte luftë e kapove të mentalitetit feudal të "gjakut të pastër" dhe palestinezëve që mbronin të drejtën për jetë.

Në anën tjetër gjendeshin " majtistet progresistë" që nuk lejonin shkatërrimin fizik të refugjatëve palestinezë dhe zbatimin e Paktit nacional për ndarjen strikte të pushtetit. Në këtë pol bënin pjesë Kemajl Xhumblati, një filozof dhe njeri i respektuar në disa qeveri, derisa regjimi sirian e vrau në pritë, pasi ai kundërshtonte lënien në mjerim të plotë dhe getoizimin e refugjatëve palestinezë, kurse Damasku, për ta "qetësuar situatën" në Liban, më 1976, sipas marrëveshjes me Egjiptin, sauditët dhe me fuqitë e mëdha, dërgoi ushtrinë e tij në këtë vend fqinj dhe kalli një luftë të hapur kundër Organizatës Çlirimtare Palestineze dhe aleatëve "të majte". Deri më sot askush nuk e di si lindën këto emërtime për Libanin "e djathtë" dhe "të majtë", por dihen aleatët e tyre që ndryshonin sipas rrethanave dhe kohës. Kështu, derisa Siria zyrtare po luftonte kundër palestinezëve dhe aleatëve të tyre në Liban, më 1976, asaj tërthorazi i ndihmonte armata izraelite që kishte invaduar deri në periferitë e Bejrutit dhe në shumë fronte palestineze në mbarë Libanin, ndonëse Izraeli dhe Siria përherë kanë qenë armiq si në luftë, ashtu edhe gjatë kohëve të paqes së rreme. Siria dëshironte ta krijonte aurën e "dorës së rregullit" në regjion, kurse Izraeli – të dëboheshin sa më parë forcat palestineze nga Libani, me motivacion se kështu ruhet siguria izraelite.

Në këtë krah ishte edhe Rashid Karame, një borgjez sunit nga veriu. Ai në postin e kryeministrit për herë të katërt, u përpoq të gjente një zgjidhje të krizës libaneze, por sapo arriti t'i tubonte të gjitha palët rreth tavolinës së bisedimeve, atij iu kurdis një fatkeqësi ajrore dhe çdo gjë u rrokullis në humnerat e thella të këtyre maleve.

Siria tradicionalisht ka caktuar presidentët, kryeministrat, madje edhe ministrat libanezë, pasi ky shtet nuk ishte në gjendje t'u bënte ballë trysnive politike dhe ushtarake të Damaskut. Hafez el Asadi, ndonëse në krye të Sirisë jo të pasur, gjente para nga arabët e pasur për të "vënë rregull" në Liban, herë me grosh e herë me plumb.

Në fillim, ndonëse po i vinte erë lufte, njerëzit e rëndomtë shpresonin se "do të kalojë edhe kjo", si në vitin 1958, kur presidenti i atëhershëm i shtetit, Kamij Shamun, kërkoi ndihmë nga jashtë për "të qetësuar" kundërshtarët politikë që po kërkonin më shumë demokraci, por nuk arriti të merrte përkrahjen e amerikanëve, të cilët jo vetëm që nuk lejuan atë të fillonte ndonjë luftë kundër taborit tjetër, por Shamunit ia ndaluan fare të shkelte në Presidencë". "Dhelpra e vjetër", siç e quanin, kishte kërkuar nga gjenerali Fuad Shehabi ta aktivizonte armatën në anën e presidentit, por ai ushtarak atdhetar, njeriu më i dashur nga të gjithë libanezët, në të gjitha kohët, nuk i dëgjoi urdhrat e presidentit bixhozçi që të luante me fatin vendit. Armata e ruajti fytyrën e saj si institucion mbarëlibanez, ndërsa general Shehabi u zgjodh njëzëri, president i Libanit. Ai e dekonfesionalizoi armatën dhe pushtetin në përgjithësi, duke filluar zbatimin e përpiktë të Kartës kombëtare libaneze të vitit 1943, kur iu vunë shtyllat shtetit laik dhe u bë ndarja e pushtetit sipas përkatësisë konfesionale. Kështu, edhe sot e kësaj dite, në Liban, presidenti zgjidhet nga radhët e arabëve të fesë ortodokse, kryeministri nga radhët e myslimanëve sunitë, kurse presidenti i Parlamentit duhet të jetë përfaqësues i myslimanëve të sektit shiitë.

**Çka pashë në Portin e Gjunjes?**

Në kaurtet rezidenciale të Bejrutit ende zhvillohej jeta "evropiane" me shkëlqim marramendës të restoranteve, kafeneve, veturave luksoze, të cilave djemtë e llastuar të familjeve të pasura ua provonin shpejtësitë edhe në rrugët e qytetit, kurse jeta e natës ishte aq frekuentuese saqë të gjithë pasanikët e vendeve të pasura me naftë vinin ta kalonin vikendin në "xhevahirin e Libanit", siç quhej Bejruti, atëherë njëmilionësh. Në Bejrut pinin uiski edhe ata që e kishin të ndaluar në vendin e tyre, aty vinin kabaretë më të njohura të botës me divat e kohës. Vetëm një program i natës i këngëtareve më të njohura arabe: Mukulthum dhe Firuz, paguhej edhe nga dy milionë dollarë. Në "Casino de Liban" Sharl Aznavuri "e kallte" diç më lirë.

Derisa luhej kjo lojë e noshalancës, në Bejrut, në portin libanez të Gjunjës, në terrin e natës ankoroheshin anije që sillnin armatim për falangën e Pjer Xhemajlit dhe për ushtrinë private të Kamij Shamunit, ndërsa në Aeroportin e Bejrutit, në pistat ndihmëse, aterronin, gjithashtu gjatë natës, aeroplanë transportues nga Iraku me armë për palestinezët dhe për të gjithë "të majtet" e tjerë. Në jug të Libanit, anijet izraelite shkarkonin armë për Shamunin dhe Sylejman Franzhijen, liderë të vjetër, përherë në pushtet, por që hanin me dy lugë: me atë arabe dhe me tjetrën - izraelite. Të gjitha këto lëvizje kryheshin pa ndonjë pompozitet. Kishte gazeta që e ngrinin zërin, porse lajmet e vërteta shpalleshin "të pavërteta" .

Në Portin e Gjunjes i kam parë vetë këto anije fantome armësh. Kisha shkuar ta vizitoja atë periferi të Bejrutit ku në vitin 1841 u vranë 4.000 ushtarë shqiptarë të armatës së Mehmet Ali Pashës, derisa po ktheheshin në Egjipt pas luftërave fitimtare kundër armatës së Portës, të cilën e komandonte Rashid Mehmet Pasha (Beteja e Konjës 1832), por betejën vendimtare për Stambollin, Pashait shqiptar, Mehmet Aliut, ia ndërprenë Austro-Hungaria dhe Anglia. Në vitin 1841, ushtria, tanimë e rraskapitur nga luftërat shumëvjeçare e Pashait të Egjiptit dhe e bijve të tij, u detyrua të tërhiqej edhe nga Siria drejt Egjiptit, duke kaluar nga Porti i Gjunjes, që atëherë ishte territor i Portës së Lartë. Aty, anijet angleze dhe forcat e këmbësorisë së tyre, zhvilluan një luftë të përgjakshme me armatën që e krijoi Egjiptin modern. Ne Gjunje u vranë shumë ushtarë, në mesin e të cilëve, sipas burimeve frënge, edhe mbi katër mijë ushtarë shqiptarë që shërbenin nën flamurin e shtetit egjiptian. Kronikët e kohës e përshkruajnë atë betejë si "skuqje të detit".

Derisa po endesha nëpër këtë port të bukur me anije flamujsh e dokumentesh të dyshimtë, parandieja se vërtet po përgatitej diçka e tmerrshme për Libanin.

Në mbrëmje, në hotelin "Fenicia" të Bejrutit po bisedonim me kolegët vendas dhe me ata të jashtëm për gjendjen në këtë shtet. Kishin "rrjedhur" lajme të sigurta se kapitali i atyre 99 bankave të mëdha të Bejrutit kishte filluar të tërhiqej drejt Stambollit, Qipros, Amanit, Parisit e Londrës. Të pasurit kishin filluar t'i regjistronin firmat në ato vende dhe fëmijët në shkolla të tjera.

Kompanitë ajrore shtuan numrin e fluturimeve, ngase nuk kishte bileta për largim, ndërsa gazetat dhe televizionet vendore kaluan ngadalë në "gjuhën e luftës", secili sipas ngjyrimeve që kishte.

Njerëzve u kishte hyrë pasiguria deri në palcë, derisa një natë, duart e përgatitura për një kohë të gjatë aktivizuan topat "155". Së pari, u dëgjuan nga veriu i Bejrutit në drejtim të jugut, e pastaj anasjelltas. Qëllohej për çdo minutë, kundër njërës dhe anës tjetër. Në atë natë verore, u vranë qindra civilë në shtëpitë e tyre të djegura nga predhat. Aq shumë ishin bërë përgatitje të sofistikuara për luftë në qytete, saqë "sektori" i vëzhguesve të goditjes së caqeve, nëpërmjet telefonit thërrisnin njerëzit "e anës" tjetër që i njihnin dhe i pyesnin: "Ku ju qëlluan". Civilët e papërvojë tregonin se "predha ka rënë nja 10 metra në perëndim të shtëpisë së filanit". Atëherë "vëzhguesit" i përmirësonin koordinatat. Njerëzit u përgjigjeshin thirrjeve të miqve të deridjeshëm, duke mos e ditur se ata ishin tjetërsuar dhe se po ndahej Bejruti përmes "vijës së gjelbër" me vendkalimin famëkeq "Qarli" ku u vranë me mijëra njerëz, duke kërkuar shpëtim në anën tjetër.

Me gjakftohtësi të tepruar po rrënohej një vend i krijuar me aq mund gjatë dymbëdhjetë shekujve.

Qendra orientale ,,Bab Idriz" e Bejrutit, si dhe "Sheshi i Topave", siç quhej që nga koha e frëngut, për një muaj u bënë rrafsh me tokë, kurse hotelet e mëdha "Holidej In", "Sen Zhorh", "Fenicia",,, Hilton,, etj., që fatkeqësisht gjendeshin buzë detit dhe afër vijës së gjelbër, u shkatërruan. Ato mbetën gërmadha nga luftonin palestinezët dhe aleatet e tyre kundër falangistëve dhe mercenarëve për ta ruajtur "kufirin" dhe veten në qytetin e rrënuar tërësisht. Llogaritet se vetëm dëmet materiale, në fund të luftës, në tërë vendin arritën në mbi 200 miliardë dollarë.

**Gazetarët vuanin për një lidhje teleksi**

Në ato kushte të vështira të luftës, ne korrespondentët, kishim vetëm një lidhje me redaksitë tona. Ai ishte teleksi me atë lentën e bardhë me vrima që bartnin në botë lajmet për një shtet që po vdiste në dhembje të mëdha. Luftë bëhej edhe për t'ua mbyllur gojën gazetarëve, që lajmet për krimet të mos depërtonin nga Libani. Së pari, gjylet shkatërruan stabilimentet në postën qendrore, duke i ndërprerë të gjitha lidhjet tokësore të telefonisë fikse. Atëherë nuk dinim asgjë për celularët.

Ngeli vetëm një lidhje teleksi, ajo nëpërmjet kabllos nënujore Bejrut - Qipro, e cila ruhej nga palestinezët, por shpesh dikush e këpuste diku larg në det, për ta bllokuar tërësisht depërtimin e çdo lajmi. Atëherë nuk kishte as internet e aq më pak mjete për lidhje satelitore. Për kohën tonë kjo ishte utopi e lexuar në faqet e shtypit shkencor. Kur nuk kishte asnjë mundësi tjetër për t'i dërguar shkrimet tona, gazetarët merreshin vesh që ato lentat e punuara të teleksit famoz t'ia jepnim një libanezi të guximshëm që me motoskafin e tij të fortë shkonte për 3 orë në Qipro. Nga atje "lëshoheshin" edhe nga njëqind raporte të gazetarëve. Kjo paguhej shtrenjtë, por megjithatë ishte më lirë se t'i mbaje në xhepa reportazhet shpesh të shkruara në gjak. Sa ua kam lakmi gazetarëve të sotëm që nuk dinë shumë për dhembjet që krijon pamundësia teknike e dërgimit të shkrimit në redaksi.

Çfarë paradoksi: gjatë tërë atyre viteve në Liban, nuk e kam parë asnjë shkrim timin në gazetën "Rilindja", ndonëse botoheshin çdo ditë. Posta libaneze nuk funksiononte në luftë, andaj nuk arrinte as gazeta ime.

Në fillim të luftës, bandat e klaneve, së pari sulmuan magazinat e Portit të Libanit. Në rrugë u nxorën me mijëra tonelata mallra që shiteshin për "kot fare". Një litër konjak (shishe) "Napolon" shitej për dy dollarë, uiski me lentë të zezë shkonte për një dollar, dhjetëshja e cigareve të shtrenjta shitej për gjysmë dollari, kurse shkrepëset e arta "Dypon", diçka më shtrenjtë: 20 dollarë pa bërë pazar. Shumë njerëz të varfër u shndërruan në shitës të mafiozëve, por numri i blerësve për çdo ditë zvogëlohej. Me kujtohet se si kryetitulli i gazetës "L'orient le jodur", paralajmëronte se Libani po bëhet "parajsë për pijanecë". Njerëzit deheshin me pak para për të qetësuar shpirtin e trazuar.

Libani ishte "i qëndisur" nga dhjetëra polici partiake e private, Armata Çlirimtare Palestineze, Armata siriane dhe "Saika" (ushtri e quajtur palestineze e pushtetit sirian me komandë dhe trupa siriane në uniforma palestineze, ndër ushtritë më gjakpirëse mu kundër palestinezëve), por shpesh edhe nga ajo izraelite. Armata e rregullt libaneze u shpërbë që në fillim të luftës së pashpallur, duke u radhitur në anët partiake e fisnore. Aeroporti nuk funksiononte. As sot nuk e kam të qartë si aterronte ndonjëherë ndonjë aeroplan i kompanisë libaneze mbi pistat e bëra gropa-gropa nga gjylet e artilerisë. Thoshin se ishte një pilot magjistar gjerman që mund të aterronte edhe mbi pistën ndihmëse njëkilometërshe. Një litër benzine kishte kërcyer nga 20 centë në 5 dollarë, korrenti mungonte edhe me nga dhjetë ditë. Hidheshin në erë përçuesit e rrymës, kurse teknikët nuk kishin guxim të hipnin në shtylla. Të gjorët ishin shndërruar në "specialitet" të snajperëve. Më ka ngjarë që edhe nga një muaj të haja kryesisht vezë dhe patate të fërguara në gaz. Vetëm këto gjendeshin aty-këtu. Supermarketet që dikur ishin shembull edhe për Evropën, mbetën tangall.

Gjatë fazave të gjata të luftimeve, familjet e gazetarëve, pasi vetëm ata dhe ndonjë diplomat i rangut të ulët, qëndronin në Bejrut, evakuoheshin jashtë shtetit, nëpërmjet një rruge të rrezikshme Bejrut – Damask. Gazetarët ktheheshin prapë në ferr. Një herë tërë familja ime shpëtoi pa ndonjë dëm, duke e ngritur një pelenë të bardhë të tim bir, Dardanit, mbi dritaren e veturës.

**Si u shpëtova të "shtunës së zezë" dhe snajperëve**

Jeta ishte bërë e trishtueshme, por edhe monotone me atë përditshmëri të lëvizjes nëpër barrikada për të arritur gjer te ngjarja e ditës. Duhej kaluar shumë rreziqe. Gati çdo javë vritej nga një gazetar në krye të detyrës. Një ditë, derisa po kthehesha me një koleg nga përcjellja e një ngjarjeje në Jordani, me të hyrë në Bejrut, vetura ime u qëllua me tre plumba nga snajper. Kishim hyrë në zonën e luftimeve midis kuarteve "Shia" dhe "Ain el Renmaneh", mu në afërsi të varrit të Pashko Vasës. U besuam disa njerëzve ne mëhallët e Damurit se në Bejrut kishte hyrë në fuqi një armëpushim, "i njëmilionti" gjatë asaj lufte. Na shpëtoi Zoti dhe shpejtësia marramendëse e "Golfit" tim që bënte zigzage të shpejta. Kur dolëm nga zona e "zjarrit", një oficer i ri i Armatës libaneze më uroi që shpëtova gjallë. Atë ditë ishim të vetmit që shpëtuam. Ishin vrarë 17 kalimtarë fatzinj. Atë ditë shkroi i tërë shtypi botëror për mrekullinë dhe për "fatin e rrallë" të gazetarit të ri ballkanik në Liban.

Por shumë më vështirë e kishin civilët vendës. Ata vriteshin vetëm se nuk i përkisnin taborit "të mbrojtur". Kam përjetuar dy herë të "shtunë të zezë", siç quhej vendosja e pritave në rrugë dhe likuidimi i menjëhershëm i njerëzve "te anës tjetër". Mua nuk me ndodhi asgjë e keqe, pasi kisha librezën e gazetarit të jashtëm, të akredituar pranë administratës vendore. Më kanë urdhëruar të largohesha sa më shpejt dhe të mos e ktheja kokën pas. Më vonë kam dëgjuar breshëri plumbash. Mu përsërit pamja e atyre civilëve të gjorë, të mbështetur për mur që me nuk ishin ndër të gjallët. Kjo më ka krijuar shumë ankth gjatë gjithë kohës sime në Liban, por edhe në Kosovë, gjatë krimeve të ushtrisë, policisë dhe paramilitarëve serbë, që bënin krime të njëjta ndaj civilëve.

Kur po kaloja një ditë rrugës së zbrazur "Hamra" të Bejrutit, pasi kisha dërguar shkrimin e ditës për "Rilindjen", papritmas më doli para Bekim Fehmiu. Aq shumë u gëzova që më në fund e pashë dikë timin. Më erdhi ta përqafoja atë pano të madhe të filmit "Odiseu", që shfaqej në kinemanë "Odeon", aty afër.

Nuk kishte problem për të siguruar një biletë, pasi atë kohë askush nuk lëvizte pa ndonjë dert të madh. Megjithatë, ishin mbushur tre rreshtat e parë të sallës.

Rrallëherë jam ndier aq i ngazëllyer duke llafosur me Bekimin, në ekran, për qëndresën e Odiseut, kurse unë nga publiku me ndjenjën e një gazetari se "kurrë nuk dihet a është kjo dita ime e fundit". Derisa po shfaqej filmi, në rrugë ndiheshin sirenat e ndihmës së shpejtë që bartnin njerëz të plagosur. Këtë ngjarje arrita t'ia tregoja Bekimit në Prishtinë para disa vjetësh. E ruaja në kujtesë si diçka të rrallë, si dashuria e parë, për t'iu falënderuar për ato dy orë në Bejrut që më bënë ta harroja për aq kohë atë luftë të vrazhdë.

**"Takimet" e përmallshme me Kadarenë dhe Bekim Fehmiun**

Libraria "Antuan", në rrugën kryesore të Bejrutit, "Hamra", ishte një supermarket i librit nga e tërë bota. Aty në kohë paqeje vinte brenda ditës edhe shtypi botëror. Ajo gumëzhinte si një koshere bletësh nga njerëz ngjyrash e gjuhësh të ndryshme. Në ditët e para të luftës së pashpallur, "Antuani" u godit me disa predha. Të tërin e kaploi flaka. Pronari, punonjësit dhe kalimtarët u përpoqën të shpëtonin atë çka mundej të shpëtohej. Duke kaluar andej, pashë shumë libra të djegur që i kishin hedhur në trotuare porsi kufomat që i shihnim çdo ditë. Duke i soditur me dhimbsuri, shikimi m'u ndal te "Gjenerali i ushtrisë së vdekur", një botim parisien. I ishte djegur gjysma e kopertinës, kurse brendia ishte e paprekur.

"Zoti Antuan, a mund ta blej këtë libër", - iu drejtova pronarit të pikëlluar, familja e të cilit, denbabaden merrej vetëm me librin.

"Nuk janë për shitje, por për hedhje. A s'po shihni çka na bënë", - m'u përgjigj shitësi i pikëlluar, sikur t'i kishin vdekur familjarët.

"Do ta marr këtë, sepse është imi" - i thashë.

Pasi e shikoi titullin m'u përgjigj: "Libri është si njeriu. Të ndihmon t'i ruash mendtë e kresë. Merre, shpëtoje.

Atë libër e ruaj edhe sot e kësaj dite. E kujtoj tërë atë ferr të Libanit dhe gëzimin që ndjeva kur takova njeriun tim, aty ku ke më së shumti nevojë ta kesh afër dikë që të frymëzon, të ngushëllon dhe të falë shpresë.

Kjo luftë zgjati 15 vjet. Përfundoi në vitin 1990. Ajo mori mbi 150 mijë jetë dhe la sakat afro gjysmë milioni njerëz, shkatërroi vendin, ndërsa të gjallëve ua la të pazgjidhur dilemën kryesore: Pse luftuam? Ndoshta përgjigjen më të saktë e dhanë analistët e pavarur libanezë, siç ishte Hasan Tueni, analist i të gjitha etapave libaneze pas pavarësisë së vitit 1945: sepse kështu deshën të tjerët, kurse libanezët e përpinë karremin. Libani ra pre e xhelozisë së arabëve të tjerë, sepse me të drejtë dëshironte të dallonte nga rrethi.

**Ajo nuk ishte një luftë fetare**

Gjakrat e konservatorëve libanezë ishin nxehur veçmas nga viti 1970 kundër 300 mijë palestinezëve që, sipas tyre, donin të bëheshin "shtet mbi shtet" në Liban, ku kishin arritur me të madhe. Atëbotë, Jordania zbatoi "Shtatorin e Zi" për t'i dëbuar nga shteti i vet strukturat politike dhe ushtarake palestineze, të cilat tentuan ta rrëzonin Mbretin Hysein, por e paguan me shumë viktima dhe dëbime. Më vonë jam takuar me një mjek shqiptar të Sirisë, që i kishte kryer studimet në Stokholm dhe ishte kthyer të shërbente në Damask. Ai më ka rrëfyer gjëra shumë tronditëse që i kishte përjetuar në kufirin jordanezo-sirian, ku gjendej i organizuar nga shteti, për të pritur palestinezët e sakatosur që dëboheshin nga Jordania. Fati i palestinezëve është si një enë e mbyllur ku çdo gyp ushtron presion mbi tjetrin, deri sa të shpërthejë. Kështu deri në pafundësi. Palestinezët mbesin popull i qëndrueshëm, por përçarjet e përhershme ndërpartiake e klanore kanë bërë që ata të mos arrijnë në cak, duke zënë në thua mu para tij. Palestinezët, fatmirësisht kurrë nuk kanë pasur ndasi fetare. Në mesin e tyre ka myslimanë dhe të krishterë: ortodoksë dhe katolikë . Ata të gjithë së bashku kanë luftuar kundër armiqve të po të feve të njëjta, andaj ky element mohon teorinë se në Liban është zhvilluar luftë fetare. Liderët e rëndësishëm palestinezë, si Zhorzh Habashi, Naef Havatme, etj., që ishin në luftë përballë falangistëve, jane të krishterë.

Gjatë takimeve me Zhorzh Habashin, themelues i Frontit Popullor për Çlirimin e Palestinës, njëherësh ndër liderët më "të padukshëm" në mesin e palestinezëve, ngase e ndiqnin për ta vrarë shumë shtete arabe dhe Izraeli, ai me kënaqësi të posaçme fliste për Shqipërinë. Dr. Habashi, me nofkën e luftës "Al Hakim" (Mjeku), ushqente simpati të madhe për Shqipërinë e bukur dhe "mbrojtësen e marksizmit",ndonëse shquhej si nacionalist i madh arab. Ai u shpëtoi shumë atentateve, pasi kishte një "nuhatje" të posaçme, si t'i mënjanonte kurthet. Habashi paraqet një paradigme të raporteve arabe. Shtetet që dikur e kërkonin kokën e tij, në fund i ofruan strehim. Vdiq më 2008 në Jordani nën kujdesin e Mbretërisë, ku më 1970 përgatiti "Shtatorin e Zi" për rrëzimin e të njëjtit Oborr mbretëror. Nga liderët palestinezë, ai ka gëzuar autoritet të veçantë në Cisjordani dhe në Gazë. Vullneti për të qëndruar në këmbë, detyroi Arafatin dhe liderët e tjerë palestinezë "t'i hanë" shpesh fjalët e tyre dhe duke rrënuar aleanca të vjetra, të krijonin të rejat. Kjo "ka qenë e zakonshme dhe e natyrshme për ta mbajtur gjallë çështjen palestineze"- më kanë thënë shumica e liderëve palestinezë.

Siç dihet, para themelimit të shtetit të Izraelit, më 1948, në Palestinë jetonin një milion e gjysmë palestinezë. Pas asaj lufte, u dëbuan rreth 800 mijë. Shumica arritën në Jordani, Siri dhe në vendet e tjera përreth. Në hotelin klasik "Melkart" të Kajros u arrit Marrëveshja midis Jaser Arafatit dhe gjeneralit libanez, Bustani, në prezencën e shteteve kryesore arabe, për strehimin e 300 mijë refugjatëve palestinezë në Liban. Refugjatët u vendosën nëpër kampe, pa të drejta pune dhe pa të drejta të tjera të qytetarëve vendorë. Jetonin nga ndihmat e UNWR-së dhe të qeverive arabe. Në ato kampe, brenda vitit lindnin rreth 30 mijë fëmijë, me gjyshër e prindër refugjatë. Gjenerata e dytë dhe ajo e tretë filluan të organizoheshin në formacione partiake siç ishin "Al Fatah" dhe forcat paraushtarake në krye me OÇP-në e Jaser Arafatit. Nga vitet '70 këto formacione e bartën luftën në viset e pushtuara palestineze, duke e shtyrë shtetin izraelit të ndërmerrte shumë sulme afatshkurtra dhe afatgjata në Liban.

Gjatë punës sime në Liban, disa herë jam takuar dhe kam shkruar edhe për pasurinë shpirtërore palestineze. Mahmut Dervish dhe Muin Psiso ishin dhe mbetën dy poetët më të mëdhenj të këtij kombi. Duke shqyrtuar ardhmërinë e popullit palestinez, Psiso më thoshte: "Sot jam me Arafatin, por nesër, kur ta krijojmë atdheun, unë do të kaloj në opozitë, sepse vetëm kështu mund t'i ndihmoj popullit tim dhe atdheut ende të ëndërruar". Me dhimbset i gjori, pasi nuk arriti ta shihte as A-në e shtetit. E mori një sëmundje e rëndë si pasojë e stresit të përhershëm të poetit më suptil arab.

Jaser Arafati, në intervistën që e dha për 'Rilindjen' në vlugun më të përgjakshëm të ballafaqimit ushtarak me falangistët dhe Sirinë në tokën libaneze, më 1976, tehun e kritikës gjithnjë e drejtonte nga Izraeli, ndërsa më thoshte se më shumë e godisnin prapaskenat e vendeve arabe. Gati të gjitha këto shtete dëshironin t'i vinin nën kapele Organizatën Çlirimtare Palestineze dhe forcat e saj të armatosura. Ndonëse vetë në ballë të luftës, ai përherë preferonte dialogun edhe me shtetet që e godisnin. Në fund atë e mundi "oreksi për të qëndruar përherë në pushtet, ndonëse kishin ndryshuar rrethanat, si në botën arabe ashtu edhe te palestinezët ne veçanti.

Fqinji jugor, Izraeli, në kohën time të reporterit, sulmonte caqet e "progresisteve" në Liban, në veçanti kampet dhe caqet ushtarake palestineze sa herë që i tekej, si nga ajri, ashtu edhe nga toka. Këto sulme në Liban kishin filluar qa nga viti 1968, kur një grup komando izraelite, u lëshua me helikopter gjatë një nate pa hënë në Aeroportin e Bejrutit dhe gjatë disa minutave ua vuri flakën 13 aeroplanëve të udhëtarëve të kompanisë ajrore libaneze "Midelist" dhe u largua pa një therë në këmbë. Madje, nuk reaguan as rojat e Aeroportit. Ishte kjo përgjigje izraelite ndaj një aksioni palestinez kundër një aeroplani të pasagjerëve të "El Alit" në Aeroportin e Athinës.

Invadimin e dytë izraelit e përjetova më 1976, kur Bejruti i rrethuar përbrenda nuk përjetoi shumë humbje, por pjesët e tjera të Libanit, po.

**Lotët në Sabra dhe Shatila**

Invadimin e tretë izraelit në Liban e ndjeva në shtator të vitit 1982, kur nëpërmjet detit, nga Qiproja arrita në Portin e Bejrutit, pasi Aeroporti ishte i mbyllur. Më kujtohet se më 20 shtator, afro 500 udhëtarë të një feriboti qipriot, pritëm disa orë në kuvertë, derisa organet portuale libaneze morën lejen nga armata izraelite që t'i kryenin formalitetet kufitare e doganore. Mirëpo, fare nuk vërehej ndonjë gjendje e jashtëzakonshme, pasi edhe ashtu gjendja ishte përherë shumë e nderë. Armata izraelite, pas rrethimit të hekurt disamujor të Bejrutit Lindor, tani kishte hyrë edhe në Bejrutin Perëndimor "progresist", pasi më 1 shtator kishte përfunduar evakuimi i forcave të armatosura palestineze në drejtim të Tunizisë, Egjiptit dhe Algjerisë. Qëllimi i rrethimit palestinez ishte i prerë: të dëboheshin nga Bejruti dhe nga qytetet e tjera të gjithë palestinezët nën armë. Presioni i rrethimit ishte aq i madh sa ndihej mungesë e ushqimeve, barnave. Mbi të gjitha forcat palestineze nuk mund t'i bënin me ballë armatës izraelite që kishte vënë një rrethim të çeliktë mbi Bejrut. Evakuimi u krye me anë të disa feriboteve të mëdha të shteteve perëndimore. Ky ishte plani amerikan i diplomatit Filip Aun, i cili kërkonte largimin e të gjitha forcave të armatosura palestineze nga Libani (rreth 15 mijë), tërheqjen e armatës izraelite nga Bejruti, mbrojtjen e civilëve të mbetur në kampet palestineze nga ana e helmetëkaltërve amerikanë, italianë dhe gjermanë dhe mbikëqyrjen e evakuimit të luftëtarëve palestinezë nga vëzhguesit ndërkombëtarë. Ato forca ndërkombëtare nuk qëndruan rreth këtyre kampeve më gjatë se 11 ditë. Më 23 gusht të po atij viti, president i Libanit u zgjodh Bashir Xhemajli, i biri i themeluesit të Falangës.

Ngjarjet rridhnin me shpejtësi filmike. Më 14 të po atij shtatori, u vra në Bejrut, Bashir Xhemajli, në një atentat me autobombë, pas të cilit pritej hakmarrja.

Bejruti dukej i vdekur. Të parin taksist që e takova, më pyeti se në cilin hotel dëshiroja të shkoja.

Në Sabra e Shatila - i thashë.

A keni qenë ndonjëherë aty? – më pyeti me habi.

Me qindra herë - iu përgjigja.

Atëherë, në rregull. Ju po i dinit të gjitha - tha ai, pasi kuptoi se isha gazetar. I gjori frikësohej t'i afrohej hyrjes së kampit Sabra e Shatila nga frika se mos po e pësonte edhe ai.

Dy ditë më parë në këto dy kampe palestineze që janë realisht kuarte të mëdha të Bejrutit Perëndimor, forcat e falangës libaneze kishin vrarë mbi dy mijë burra, me pretekst se po kërkonin ende palestinezë të armatosur, të cilët gjoja nuk ishin evakuuar me feribotet e ndërkombëtarëve. Sipas tyre, në këto kampe mund të fshihej atentatori ndaj presidentit libanez dhe shefit e partisë së tyre "Kataeb".

Falangistët i kishin tubuar gratë dhe fëmijët palestinezë në një stadium të afërt, kurse burrat i kishin ekzekutuar në grupe. Me buldozerë kishin hapur varreza masive, kurse rreth një mijë kufoma i kishin marrë me vete për t'i varrosur në vende të panjohura, me qëllim që të fshihej krimi. Andaj, numri i saktë i viktimave civile, të cilat, sipas dëshmitarëve të huaj, nuk bënë kurrfarë rezistence të armatosur, nuk arriti të saktësohej as pas hulumtimeve të mëvonshme të Komisionit të Qeverisë izraelite, Kahan, sipas udhëheqësit të tij, një gjyqtari të Gjykatës Supreme në Jerusalem. Ai shpalli fajtor si falangën libaneze ashtu si armatën libaneze, por po ashtu edhe gjeneralin famëkeq izraelit, Ariel Sharon, i cili me disa ushtarë të tij kishte bërë vetëm rrethimin e kampeve dhe u kishte dhënë xhelatëve ndihmë logjistike.

Ndonëse masakra kishte ndodhur dy ditë më parë, kur unë arrita brenda, nga kampet ishin hequr gjurmët e rënda të krimit, pasi numri i gazetarëve të huaj po shtohej për çdo orë. Mbretëronte një qetësi varri, ndonëse aty-këtu shiheshin gratë e fëmijët e mbetur duke shikuar nga dritaret e mbyllura të shtëpive. Ende kundërmonte erë kufomash dhe gjaku të ngjizur. Ne Liban kam qarë shpesh, duke parë skena trishtuese, por në Sabra e Shatila iu dorëzova tërësisht ndjenjave njerëzore. Më nuk isha gazetar që ruan distancën, por një krijesë e pafuqishme që mbështet shpirtin mbi lotët e vet.

I pari në këto kampe hyri gazetari i "Indipendentit" londinez, Robert Fisk. Ai lajmëroi menjëherë botën për këtë gjenocid. Gazetari i mirënjohur izraelit, Amnon Kapeliuk, pohon se vetëm Kryqi i Kuq ka bartur dy mijë kufoma palestineze, kurse falangistët i kanë varrosur në vende të panjohura edhe një mijë kufoma të tjera.

Kur hyra në këto kampe, dy ditë mas masakrës së paparë të falangistëve, kishin mbetur pa u varrosur vetëm disa kuaj të bardhë, të vrarë së bashku me pronarët e tyre.

Për këtë masakër kam shkruar në disa vazhdime, falë dëshmive të atyre që kishin shpëtuar dhe të një ekipi norvegjez të Kryqit të Kuq. Ata ishin gjendur në këto dy kampe në natën e gjatë të ferrit. Atëherë kam menduar se kjo masakër nuk mund të përsëritet më në botën e civilizuar. Fatkeqësisht, koha më përgënjeshtroi, në vendin tim, kur përjetuam sa shumë zhvarrosje të shqiptarëve dhe hapje të varrezave masive në Serbi e gjetiu që krimineli t'i humbiste gjurmët e krimit mbi civilët.

Më vonë, autoritetet libaneze e zunë dhe e dënuan vrasësin e presidentit libanez që u shfrytëzua si shkas i masakrës. Ai ishte një shtetas sirian, i njohur me viktimën edhe më parë. Ai nuk pranoi kush e kishte paguar, por supozohej se këtë e kishte bërë Damasku zyrtar, pasi Beshir Xhemajli kishte nënshkruar traktate bashkëpunimi ekonomik dhe ushtarak me Tel-Avivin.

Për mua, person titan libanez ka qenë Rafik Hariri, dy herë kryeministër i vendit që nga viti 1992, kur Bejruti doli nga lufta 15-vjeçare, i tëri në gërmadha falë fuqisë së tij mbinjerëzore Libani u kthye në një shtet tërësisht normal. Hariri arriti që me ndihmën e kapitalit saudit, të shteteve të tjera të pasura me naftë, por edhe nga Evropa të nxjerrë në dritë një Bejrut tërësisht të ri, por që i ka ruajtur tiparet e tij karakteristike. Hariri forcoi ekonominë që ishte në kukëza, arriti të rikrijojë raporte normale midis të gjitha komuniteteve dhe kur të gjitha këto i arriti, kërkoi nga Siria t'i tërhiqte 15 mijë ushtarët e saj, të stacionuar në Liban që nga viti 1967. Kjo kërkesë për Damaskun zyrtar qe "e tepërt dhe e guximshme", andaj, sipas praktikave të njohura siriane, në Liban, Haririt ia organizoi një atentat spektakular me autobombë. Ai ndërroi jetë më 14 shkurt 2005.

Armata izraelite mbeti pjesërisht në jugun e Libanit (zona e sigurisë) deri në vitin 2001, por më 2006 u detyrua të tërhiqej tërësisht, pas luftimeve të përgjakshme me "Hezbullahun".

**Luftë, së cilës i frynë të gjithë**

Edhe sot kur përpiqem t'i shikoj prapaskenat e luftës libaneze, nga një distancë e mirë kohore, nisem nga një fakt i shtruar nga shumë analistë, se Libani i vogël nuk ka mundur ta bënte vetë një luftë 15-vjeçare, e cila kushtoi me miliarda dollarë vetëm për armatim. Mbetet enigma se kush e "kallte" sërish pas shumë armëpushimeve, kur libanezët e gjorë ishin të lodhur dhe nuk donin më luftë.

Në lëkurën e këtij vendi të vogël po luhej një bixhoz i madh i superfuqive dhe i vendeve arabe që po jepnin prova para Izraelit dhe aleatëve se po i "edukonin" palestinezët për ta rikthyer Golanin (Siria) ose "frenimi" i naseristëve libanezë dhe i progresistëve të tjerë që të mos ndërmerrnin aksione subversive nga Libani në Izrael (Egjipti).

Gjatë pauzave disajavore të qetësisë relative, mjaftonin të vepronin dy snajperë për ta kthyer pasigurinë dhe rifillimin e luftës që jo vetëm civilët, por as partitë kundërshtare më nuk e dëshironin.

Sipas analistëve të gazetës "Le Figaro", Izraeli kishte tri qëllime: të hakmerrej në Liban, para opinionit të vet, për sulmet që i bënin nga jugu i Libanit, presioni mbi Qeverinë e brishtë libaneze që ta shpallte nul Marrëveshjen e Kajros të vitit 1970, sipas së cilës palestinezët u lejuan të vendoseshin në kampet e Libanit, si dhe me çdo kusht, në jugun e Libanit të ndahej popullsia e sektit shiit nga palestinezët. Në këtë drejtim, shiitet libanezë kalonin lirshëm kufirin dhe shkonin në Izrael për nevoja të ndryshme prej atyre komerciale, e deri te ato mjekësore. Kjo gjendje vazhdoi disa vjet, derisa "Hezbollahu", me ndihmën e Sirisë dhe Iranit, i përforcoi pozitat në jug të Libanit, prej ku shiitët u bënë kurrizi i kësaj Lëvizjeje, e cila arriti ta detyronte Izraelin të tërhiqej tërësisht nga centimetri i fundit libanez (2006).

Sot flaka e luftës civile në Siri po e shtrin gjuhën e saj vdekjeprurëse edhe në Liban, por, me gjasë, ata që i ka djegur qumështi, tani i fryjnë edhe kosit. Libanezët më nuk duan të bëhen monedhë për kusuritje, e aq më parë nuk kanë nevojë për "Pranverën" e tyre arabe. Libanezët kaluan shumë "pranvera" pa behar, por nxorën shumë mësim nga pësimet e veta. Liderët tradicionalë të forcave libaneze kanë vdekur së bashku me pasardhësit e tyre të parë.

Ky është edhe zëri i një shteti që qëndroi gjatë në koma, por nuk pësoi amnezi, falë edhe gazetarëve.

© Nehat Islami